



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI

Kryesia e Kuvendit

P-003

Prishtinë, më 20 shtator 2017, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 20 SHTATOR 2017

Në mbledhje morën pjesë: Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit; Aida Dërguti, Kujtim Shala, Slavko Simiq dhe Mufera Shinik, nënkryetarë të Kuvendit.

Nga grupet parlamentare: Glauk Konjufca, Avdullah Hoti, Memli Krasniqi, Sasha Milosavljeviq, Ahmet Isufi, Bilall Sherifi dhe Albert Kinolli.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Valmir Klaiqi dhe Gazmend Krasniqi;

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Fehmi Hyseni, Shefki Shoshaj, Osman Shatri dhe Musli Krasniqi.

Nga OSBE-ja: Saniye Berisha,

Nga EUSR-ja: Blerta Bejtullahu,

Nga NDI-ja: Rinor Beka dhe

Nga KDI-ja: Albert Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit.

Kryetari e hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës. Kryesia, me propozimin e kryetarit, i zhvilloi punimet me këtë:

Rend dite

1. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të Kryesisë së Kuvendit,
2. Njoftim për formimin e grupeve parlamentare,
3. Shqyrtimi i Propozimit për formimin e komisioneve parlamentare dhe
4. Caktimi i datës për vazhdimin e seancës së jashtëzakonshme.

1. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të Kryesisë së Kuvendit

Kryesia i miratoi pa vërejtje procesverbalet e mbledhjeve të Kryesisë, të mbajtura më 8 dhe 10 shtator 2017.

Ndërsa nënkryetari i Kuvendit, Kujtim Shala, pati vërejtje në transkriptin e mbledhjes së Kryesisë së Kuvendit, të mbajtur më 10 shtator 2017, i cili është korrigjuar, sipas vërejtjes së dhënë.

2. Njoftim për formimin e grupeve parlamentare

Kryetari i njoftoi anëtarët e Kryesisë me listat e deputetëve të dërguara për formimin e grupeve parlamentare.

Kryesia, pasi u njoftua me formimin e grupeve parlamentare, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

Grupet parlamentare të Legjislaturës VI janë si në vijim:

- 1 Grupi Parlamentari i Lëvizjes “Vetëvendosje”, me 32 deputetë, kryetar Glauk Konjufca.
2. Grupi Parlamentar i LDK-së, me 27 deputetë, kryetar Avdullah Hoti.
3. Grupi Parlamentar i PDK-së, me 24 deputetë, kryetar Memli Krasniqi.
4. Grupi Parlamentar Lista serbe, me 10 deputetë, kryetar Sasha Milosavljeviq.
5. Grupi Parlamentar i AAK-së, me 9 deputetë, kryetar Ahmet Isufi.
6. Grupi Parlamentar i “Nismës për Kosovën”, me 6 deputetë, kryetar Bilall Sherifi.
7. Grupi Parlamentar “6+”, me 6 deputetë, kryetar Albert Kinolli.

Më pas, kryetari e hapi diskutimin për ndarjen e zyrave për akomodimin e deputetëve dhe të grupeve parlamentare.

Lidhur me ndarjen e zyrave për akomodimin e deputetëve dhe grupeve parlamentare diskutuan: Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit, Aida Dërguti, Kujtim Shala, nënkryetarë të Kuvendit, dhe Avdullah Hoti, kryetar i Grupit Parlamentar të LDK-së, Bilall Sherifi, kryetar i Grupit Parlamentar të “Nismës për Kosovën”, si dhe Ismet Krasniqi, Sekretar i Përgjithshëm i Kuvendit, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me ndarjen e zyrave për akomodimin e deputetëve dhe grupeve parlamentare, vendosi që një nënkryetar i pozitës dhe një nënkryetar nga opozita, në bashkëpunim edhe me Administratën e Kuvendit ta përfundojnë ndarjen e zyrave.

3. Shqyrtimi i Propozimit për formimin e komisioneve parlamentare

Kryetari i njoftoi të pranishmit me propozimin për formimin e komisioneve parlamentare, si dhe formulën për ndarjen e tyre.

Ai tha se me Rregulloren e Kuvendit janë të parapara 16 komisione parlamentare, ndërsa në Legjislaturën V të Kuvendit kanë qenë 14 komisione parlamentare. Ai propozoi që edhe në Legjislaturën VI të formohen 14 komisione parlamentare.

Lidhur me këtë pikë diskutuan: Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit, Kujtim Shala, nënkryetar i Kuvendit, Memli Krasniqi, Avdullah Hoti, Bilall Sherifi dhe Ahmet Isufi, kryetarë të grupeve parlamentare, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me propozimin e lartshënuar, bëri ndarjen e komisioneve parlamentare, si në vijim:

Për kryetarë të komisioneve parlamentare:

Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje” do t’i drejtojë këto komisione parlamentare:

1. Komisionin për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit,
2. Komisionin për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini, Sporte, Inovacione dhe Ndërmarrësi,
3. Komisionin për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale dhe
4. Komisionin për Mbikëqyrjen e Agjencisë Kosovare për Inteligjencë.

Grupi Parlamentar i LDK-së do t'i drejtojë këto komisione parlamentare:

1. Komisionin për Buxhet dhe Financa,
2. Komisionin për Punë të Jashtme, Diasporë dhe Investime Strategjike dhe
3. Komisionin për Mbikëqyrjen e Financave Publike.

Grupi Parlamentar i PDK-së do t'i drejtojë këto komisione parlamentare:

1. Komisionin për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal,
2. Komisionin për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Medie,
3. Komisionin për Integritet Evropian.

Grupi Parlamentar i AAK-së do ta drejtojë:

1. Komisionin për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis e Planifikim Hapësinor.

Grupi Parlamentar i Listës serbe do ta drejtojë:

1. Komisionin për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe për Kthim.

Grupi Parlamentar i “Nismës për Kosovën” do ta drejtojë:

1. Komisionin për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës.

Grupi Parlamentar “6+” do ta drejtojë:

1. Komisionin për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione.

Ndërsa, për zëvendëskryetarë të parë të komisioneve parlamentare:

Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje” zëvendëskryetarë të parë do të ketë në këto komisione parlamentare:

1. Komisionin për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal,
2. Komisionin për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës,
3. Komisionin për Administratë Publike, Qeverisje Lokale, Media dhe Zhvillim Rajonal,
4. Komisionin për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe për Kthim.

Grupi Parlamentar i LDK-së zëvendëskryetarë të parë do të ketë në këto komisione parlamentare:

1. Komisionin për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis e Planifikim Hapësinor,
2. Komisionin për Integritet Evropian dhe
3. Komisionin për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione.

Grupi Parlamentar i PDK-së zëvendëskryetarë të parë do të ketë në këto komisione parlamentare:

1. Komisionin për Buxhet dhe Financa,
2. Komisionin për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit,
3. Komisionin për Mbikëqyrjen e Agjencisë Kosovare të Inteligjencës dhe
4. Komisionin për Mbikëqyrjen e Financave Publike.

Grupi Parlamentar i AAK-së zëvendëskryetarë të parë do të ketë në këto komisione parlamentare:

1. Komisionin për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini, Sporte, Inovacione dhe Ndërmarrësi dhe
2. Komisionin për Punë të Jashtme, Diasporë dhe Investime Strategjike.

Grupi Parlamentar i “Nismës për Kosovën” zëvendëskryetar të parë do të ketë në këtë komision parlamentar:

1. Komisionin për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale.

Kryesia lidhur me ndarjen e pozitave të zëvendëskryetarëve të dytë në komisionet parlamentare, nga grupet parlamentare të komuniteteve që nuk janë shumicë dhe për caktimin e deputetëve në pozitat për kryetarë, zëvendëskryetarë dhe anëtarë nëpër komisionet parlamentare, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

1. Kërkohej nga të gjitha grupet parlamentare që t'i propozojnë emrat e deputetëve për kryetarë, zëvendëskryetarë dhe anëtarë të komisioneve parlamentare deri të hënën, më 25 shtator 2017, në orën 12:00.

2. Kërkohej nga grupet parlamentare të komuniteteve që nuk janë shumicë që t'i dërgojnë propozimet për ndarjen e pozitave të zëvendëskryetarëve të dytë të komisioneve parlamentare deri të hënën, më 25 shtator 2017, në orën 12:00.

4. Caktimi i datës për vazhdimin e seancës së jashtëzakonshme

Kryetari i njoftoi të pranishmit me shkresën e nënkryetarit të Kuvendit, Kujtim Shala, i mbështetur edhe nga 5 deputetë nënshkrues, me të cilën kishin kërkuar caktimin e kohës për vazhdimin e seancës së jashtëzakonshme, të filluar më 10 shtator 2017, lidhur me debatin për Parimet programore të Qeverisë së Kosovës, 2017-2021.

Nënkryetari i Kuvendit, Kujtim Shala, propozoi që seanca e jashtëzakonshme t'i vazhdojë punimet më 25 shtator 2017, në orën 10:00.

Lidhur me propozimin e nënkryetarit të Kuvendit, z. Shala, diskutuan: Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit, Ahmet Isufi, Glauk Konjufca, Bilall Sherifi, Memli Krasniqi dhe Avdullah Hoti, kryetarë të grupeve parlamentare, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Pas diskutimeve, kryetari e hodhi në votim propozimin e nënkryetarit z. Shala, për caktimin e datës për vazhdimin e seancës së jashtëzakonshme.

Kryetari konstatoi se propozimi i nënkryetarit të Kuvendit, z. Shala, për vazhdimin e seancës së jashtëzakonshme nuk u mbështet nga anëtarët e Kryesisë së Kuvendit, ngase vetëm dy vota ishin "për" (Aida Dërguti dhe Kujtim Shala).

Pas konstatimit të votimit lidhur me propozimin e nënkryetarit të Kuvendit, z. Shala, diskutuan Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit, Kujtim Shala dhe Aida Dërguti, nënkryetarë, si dhe Bilall Sherifi, kryetar i Grupit Parlamentar të "Nismës për Kosovës", diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Më pas, Aida Dërguti, Kujtim Shala, nënkryetarë të Kuvendit, Glauk Konjufca dhe Avdullah Hoti, kryetarë të grupeve parlamentare, në shenjë pakënaqësie e lëshuan mbledhjen e Kryesisë së Kuvendit.

Kryetari, në mungesë të kuorumit, e mbylli mbledhjen e Kryesisë së Kuvendit në orën 13:25 minuta.

Kryetari i Kuvendit:

Kadri VESELI

Procesverbalin e hartoi:

Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale